



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 14435 prot.

Tiranë, më 30.7.2018

Fletorja Zyrtare nr 118

UDHËZIM

Nr. 26, datë 30.7 2018

**PËR
KATALOGUN KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE**

Në mbështetje të nenit 17 pika 2 të ligjit nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”,

UDHËZOJ:

1. Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale (KKKP) është një instrument dinamik, i cili liston dhe bën të aksesueshme për ofruesit e AFP dhe të gjithë personat e interesuar informacion për të gjitha kualifikimet profesionale që përfshihen në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), sipas nivelit të caktuar.
2. KKKP përbëhet nga emërtimet dhe standardet (përshkruesit) përkatëse për secilin kualifikim në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat.
3. KKKP klasifikon dhe integron kualifikimet për arsimin dhe formimin profesional në nivelet 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të bazuara në rezultate të nxënimit dhe përshkruesit përkatës të niveleve të KSHK, duke identifikuar për çdo kualifikim nivelin përkatës të referencës në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, duke filluar nga niveli më madh i agregimit që ka të bëjë me fushat e kualifikimit (drejtimet), deri në nivelin më të ulët të agregimit (nën fushat e kualifikimit), që ka të bëjë me profilet dhe specialitetet.
4. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), në bashkëpunim me komitetet sektoriale përkatëse, inicion hartimin dhe mirëmbajtjen e KKKP duke propozuar përfshirjen, hartimin dhe rishikimin e standardeve të profesioneve, standardeve të kualifikimeve profesionale, standardeve përkatëse të vlerësimit të niveleve 2-5 të KSHK-së.

5. Propozimi nga AKAFPK për miratimin e përfshirjes së kualifikimeve profesionale në KKKP bëhet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të vlefësimit (validimit) të tyre nga grupe ekspertësh të fushës të cilat ngrihen nga AKAFPK deri në ngritjen e Komiteteve Sektoriale. Kriteret dhe procedurat e validimit përcaktohen në një rregullore të posaçme për përfshirjen e kualifikimeve profesionale në KKKP, të miratuar nga AKAFPK.
6. Miratimi i KKKP është procesi përmes të cilit Ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional, në bazë të propozimit të hartuar nga AKAFPK, miraton përfshirjen në KKKP të kualifikimeve profesionale për nivelet 2-5 të KSHK.
7. Miratimi i përfshirjes së kualifikimeve profesionale në KKKP-së është i vlefshëm për një periudhë 4-vjeçare, pas së cilës kualifikimet profesionale duhet t'i nënshtrohen sipas të njëjtës procedurë procesit të miratimit.
8. Vendimi i miratimit të KKKP-së duhet të përfshijë emërtimin e kualifikimeve profesionale, nivelin përkatës në KSHK, volumin e të nxënit, kohëzgjatjen e periudhës së miratimit, si dhe anekse të dokumenteve zhvillimore që shoqërojnë çdo kualifikim profesional.
9. KKKP për nivelet 2-5 të KSHK publikohet në faqen e internetit të AKAFPK.
10. Ngarkohet njësia përgjegjëse për AFP-në në Ministri dhe AKAFPK për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

